



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 20588 Prot.

Lezhë, më 03 . 12 . 2025

VENDIM

Nr. 112, Datë 26. 11. 2025

PËR MIRATIMIN E KRIJIMIT TË BANDËS MUZIKORE TË QYTETIT

Në zbatim të ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 25, pika 1 e 2 dhe sipas vendimit të Rregullores së Brendshme të Bashkisë Lezhë "Mbi Organizimin, Funkcionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Bashkisë Lezhë dhe Njësive Administrative" Nr. 393, Dt.18.07.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë dhe pas diskutimit, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

Vendosi:

1. Krijimin e Bandës Muzikore të Qytetit, prej 19 vetash, nga të cilët 1 dirigjent dhe 18 instrumentistë.
2. Banda Muzikore përfaqëson qytetin e Lezhës në ceremoni, festa kombëtare e lokale, parakalime, marshime dhe aktivitete të Bashkisë Lezhë, koncerte kulturore brenda dhe jashtë qytetit, projekte edukative, bashkëpunime me shkolla dhe institucione të tjera artistike. Prania e saj rrit dinjitetin kulturor të qytetit dhe krijon identitet të dallueshëm artistik.
3. Secili muzikant i kësaj bande angazhohet të ofrojë shërbime artistike si instrumentist, përfshirë pjesëmarrjen në prova të rregullta javore, pjesëmarrjen në performanca publike gjatë vitit, përgatitjen profesionale për aktivitetet.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI





1a B

Nr. 20588/1 prot

Dt: 12.12.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIKNr. 1191/10 Prot.Lezhë, më 11.12.2025

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr. 107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut" të ndryshuar; nenin 54 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 112, datë 26.11.2025 të këshillit të bashkisë Lezhë "Për miratimin e krijimit të bandës muzikore të qytetit".

PREFEKTI

Taulant MALSHI

